

**VENDIM**  
**Nr. 6, datë 6.1.2020**

**PËR KUSHTET, KRITERET DHE PROCEDURAT PËR ZBATIMIN E MASAVE  
TË RIMËKËMBJES EKONOMIKE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe të ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

**I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

1. Ky vendim ka si objekt përcaktimin e procedurave për zbatimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike, si dhe përcaktimin e kushteve e të kriterëve për përfitimin e saj prej personave, tregtarëve dhe shoqërive tregtare, të vogla dhe të mesme, vendet e kryerjes së aktivitetit të të cilave janë dëmtuar dhe/ose zhvendosur për shkak të fatkeqësisë natyrore, me qëllim rikonstruksionin e shpejtë ose sigurimin e mjediseve të përshtatshme për kryerjen e veprimtarisë nga punëmarrësit.

2. Skema e mbështetjes së rimëkëmbjes ekonomike përfshin:

a) dhënien e përfitimeve të papunësisë për punëmarrës që kanë mbetur të papunë për shkak të shembjes, dëmtimit ose të zhvendosjes së vendit të punës;

b) mbështetjen financiare të tregtarëve dhe shoqërive tregtare, me qëllim rikonstruksionin e shpejtë të vendit të zhvillimit të aktivitetit tregtar.

3. Përfitojnë nga masat e rimëkëmbjes ekonomike:

a) personat dhe tregtarët e shoqëritë tregtare, të cilët ushtrojnë veprimtarinë e tyre ekonomike në bashkitë dhe njësitë administrative, në territorin e të cilave është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore;

b) subjektet, sipas përcaktimit të pikës 5, të nenit 5, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

Nuk përfitojnë sipas këtij vendimi, subjektet e përcaktuara në pikën 6, të nenit 5, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”.

**II. DHËNIA E PËRFITIMEVE TË PAPUNËSISË DHE MBËSHTETJA FINANCIARE E TREGTARËVE DHE SHOQËRIVE TREGTARE, ME QËLLIM RIKONSTRUKSIONIN E SHPEJTË**

4. Tregtarët dhe shoqëritë tregtare kërkojnë pranë njërive të vetëqeverisjes vendore ku ushtrojnë aktivitetin:

a) dhënien e përfitimeve të papunësisë për punëmarrësit e tyre;

b) mbështetjen financiare për rikonstruksionin e vendndodhjes së biznesit.

5. Kushtet për dhënien e përfitimeve të papunësisë janë, si më poshtë vijon:

a) punëdhënësi të jetë një ndërmarrje e vogël apo dhe e mesme, në kuptim të nenit 4, të ligjit nr. 8597, datë 17.10.2002, “Për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme”, të ndryshuar;

b) në momentin e ndodhjes së fatkeqësisë natyrore, punëmarrësi të jetë në marrëdhënie pune të vërtetuar me pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, prej jo më pak se një muaj, sipas dokumentacionit të përcaktuar në shkronjën “b”, të pikës 6, të këtij vendimi;

c) të mos jetë i punësuar ose i vetëpunësuar në një vend tjetër;

ç) të mos refuzojë masat sociale të përcaktuara në shkronjën “a”, të pikës 1, të nenit 29, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, nga zyra përkatëse e punësimit apo njësitë e vetëqeverisjes vendore;

d) punëmarrësit të jenë të përfshirë në listat e miratuara nga njësia e vetëqeverisjes vendore.

6. Administratori i shoqërisë tregtare/i vetëpunësuar i aplikon pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin, duke paraqitur për çdo punëmarrës dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- a) një kërkesë për përfitim të ardhurash nga papunësia;
- b) vërtetim mbi pagimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- c) dokument identifikimi (fotokopje);
- ç) aktkonstatimi të Institutit të Ndërtimit se janë të dëmtuar dhe/ose të zhvendosur për shkak të fatkeqësive natyrore.

7. Njësitë e vetëqeverisjes vendore e shqyrtojnë dokumentacionin sipas pikës 6, të këtij vendimi, dhe pas miratimit të listave të punonjësve dhe fondit të nevojshëm ia dërgon për zbatim, periodikisht, zyrës përkatëse të punësimit.

8. Zyra e punësimit jep përfitimet e papunësisë duke zbatuar kriteret e pikës 5, të këtij vendimi.

9. Kushtet për mbështetjen financiare të tregtarëve dhe shoqërive tregtare janë, si më poshtë vijon:

a) Të kenë pësuar dëme materiale të pronës të shkaktuara nga fatkeqësia natyrore, sipas aktkonstatimit të Institutit të Ndërtimit, dhe kanë ndërprerë aktivitetin e tyre ekonomik, si pasojë e dëmtimit dhe/ose zhvendosjes së tij, për rikuperimin e të cilave kërkohet:

- i. riparim, rikonstrukcion ose rindërtimin i ndërtesave për qëllime prodhimi dhe shërbimi;
- ii. mbulim i dëmtimeve të pasurive të paluajtshme e të luajtshme, përfshirë stoqet dhe magazinat;
- iii. për zhvendosjen e aktivitetit ekonomik të tyre, brenda të njëjtës njësi të vetëqeverisjes vendore, për një masë zhdëmtimi, që nuk e tejkalon dëmin që ka pësuar ndërtesa, në kuptim të nënndarjes “I” më lart.

b) Administratori i shoqërisë tregtare/i vetëpunësuar i aplikon pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ushtron aktivitetin, duke paraqitur dokumentacionin, si më poshtë vijon:

- i. Kërkesë për mbulimin e shpenzimeve për riparimin e dëmtimeve. Në rast se ka zhvendosur aktivitetin, duhet të paraqesë koston e zhvendosjes;
- ii. përlllogaritjen e dëmtimeve të pësuar, të certifikuar nga organet përkatëse shtetërore;
- iii. vlerën e dëmit të shkakuar nga ndërprerja e aktivitetit ekonomik, në bazë të deklaratave të pasqyrave financiare të tria viteve të fundit të ndërmarrjeve të paraqitura pranë zyrave tatimore;
- iv. vlerën e shpenzimeve së bashku me preventivin përkatës, për mbulimin e dëmtimeve/ose koston e zhvendosjes së aktivitetit;
- v. deklaratë se nuk ka një kontratë të sigurimit të biznesit pranë agjencive të sigurimeve (në qoftë se disponohet).

10. Kërkesat për të përfituar dhënien e përfitimit të papunësisë dhe të mbështetjes financiare bëhen pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku ndodhet selia e ndërmarrjes, brenda tre muajve nga shpallja e gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

11. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, me marrjen e aplikimeve përkatëse, brenda 15 ditëve bëjnë vlerësimin dhe verifikimin e dokumenteve të dorëzuara.

12. Njësitë e vetëqeverisjes vendore përgatisin kërkesën pranë Komisionit Shtetëror të Rindërtimit për dhënien e fondeve të përfitimeve të papunësisë dhe të mbështetjes financiare të rimëkëmbjes, të shoqëruar me listat e subjekteve dhe të individëve përfitues.

13. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit me marrjen e kërkesës nga njësitë e vetëqeverisjes vendore e shqyrton brenda 15 ditëve dhe vendos, sipas rastit, për pranimin e tyre dhe shkallën e mbështetjes, duke i propozuar Këshillit të Ministrave miratimin e fondit përkatës. Komisioni ka të drejtë të kërkojë plotësimin me dokumentacion shtesë, si dhe afatin përkatës për plotësimin e tyre nga njësitë e vetëqeverisjes vendore apo refuzimin e kërkesave duke dhënë argumentet përkatëse.

14. Fondet për dhënie e përfitimeve të papunësisë për punëmarrësit i akordohen zyrës përkatëse të punësimit, ndërsa fondet për mbështetjen financiare për rikonstrukcionin e biznesit i akordohen njësisë përkatëse të vetëqeverisjes vendore.

### III. DISPOZITA TË FUNDIT

15. Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe zyrat e punës krijojnë dhe monitorojnë regjistrat me listën e subjekteve përfituese, masën përkatëse të përfituar, si dhe mënyrën e pagesave, e cila do të publikohet në faqen zyrtare të njësisë së vetëqeverisjes vendore.

16. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe zyrat e punës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR  
**Edi Rama**